



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1918/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., me adresë rr. V.Dragaj pn, në Mitrovicë, me NRB: 70465104, kundër debitorit Korabi Show-2, me adresë në rr. Ismajl Qemajli, në Vushtrri, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti i për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2055/23 të datës 30.08.2024, me datë 20.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., me adresë rr. V.Dragaj pn, në Mitrovicë, me NRB: 70465104, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2055/23 i datës 30.08.2024, dhe çështja gjykohet si në vijim:

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Korabi Show-2, me adresë në rr. Ismajl Qemajli, në Vushtrri, i ushtruar kundër Urdhrit përmbarimor P.nr.1523/23 datës 25.10.2023 i lejuar nga përmbaruesi privat Atip Mustafa, dhe Përfundohet në tërsi përmbarimi në këtë çështje përmbarimi

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 2055/23 të datës 30.08.2024, e ka Pranuar si të

bazuar prapësimin e debitorit Korabi Show-2, me seli në Vushtrri dhe ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.1523/23 të datës 25.10.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Atip Mustafa.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., me seli në Mitrovicë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar, ndërsa aktvendimi i kundërshtuar të prishet dhe të sjellet vendim meritör.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., me adresë rr. V.Dragaj pn, në Mitrovicë, me NRB: 70465104, me datën 25.10.2023 ka paraqitur propozim për përmbarim, kundër debitorit Korabi Show-2, me seli në Vushtrri, në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga librat e Kontabilitetit me shifër VU.5.B.46.4177, në shumë të përgjithshme prej 294.00€.

Përmbaruesi Atip Mustafa, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A me seli në Mitrovicë, ka caktuar urdhrin përmbarimor KPPP.nr.1523/23 të datës 25.10.2023 duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Ekstraktit të verifikuar nga librat afarist VU.5.B.46.4177 të datës 26.09.2023, të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve nga dokumenti i besueshëm i lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguajë kreditorit shumën prej 294.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8% duke e llogaritur nga data e paraqitjes së propozimit e deri te pagesa definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, dhe të gjitha këto detyrime të realizohen përmes zbatimit të përmbarimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare të kreditorit, dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në

Ilogarinë e tij bankare, përbarimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, për shkak se dokumenti i propozuar nuk është i besueshëm dhe nuk është i përshtatshëm për përbarim, se propozimi përbarimor i takon periudhës 2018-2023, dhe se nuk ka kartelë financiare të barazimit. Më tutje ka theksuar se organi përbarues, ka nxjerr urdhrin përbarimor në bazë të dokumentit fiktiv të ofruar nga kreditori, pasi që në rastin konkret mungon komplet dokumentacioni, duke shtuar se dokumenti i besueshëm nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përbarueshmërisë. I ka propozuar gjykatës që aprovohet prapësimi i debitorit, dhe të shfuqizohet urdhri përbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se në rastin konkret, procedura përbarimore është bazuar në faturat apo ekstraktet e paraqitura nga ana e kreditorit të cilat i përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme duke u bazuar në nenin 40 të LPP-së. Më tutje ka theksuar se ekstrakti përmban të gjitha të dhënat e borxhit, pagesave të kryera ose jo, numrin identifikues të faturave, dhe datën e tyre për secilën faturë veç e veç. Ka shtuar se borxhi kërkohet për periudhën prej datës 30.06.2020 deri më 31.08.2023 dhe jo siç pretendon debitori prej vitit 2018. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri i Përbaruesit Privat

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 2055/23 të datës 30.08.2024, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Korabi Shoë-2, me seli në Vushtrri dhe ka anuluar Urdhrin Përbarimor P.nr.1523/23 të datës 25.10.2023, të lejuar nga Përbaruesi Atip Mustafa.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në rastin konkret dokumenti i besueshëm ekstrakti i verifikuar nga librat afarist VU.5.B.46.4177 dt.26.09.2023 në bazë të cilit është lejuar urdhri për përbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 par.1 nenp.1.2 LPP-së. Bazuar në këtë dispozitë ligjore si dokumente te besueshme janë përcaktuar ekstraktet e verifikuara nga librat afarist sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave. Në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është krijuar dhe është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitori.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhomat e shkallës së dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e dhomës së shkallës së parë.

Në këtë rast Dhoma e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 29, 37 dhe nenin 71 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat në lëndë, e mbi të cilën mund të iniciohet procedura e përmbarimit.

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dokumenti i besueshëm – ekstrakti i verifikuar nga librat afarist VU.5.B.46.4177, në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbarimore, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se dokumenti- ekstrakti është lëshuar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, në vlerë totale të borxhit prej 294,00€, andaj ekstrakti financiar i kreditorit, është dokument i besueshëm, i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, si dhe i plotëson kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3, 1.4 të LPP-së, që parasheh:

Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është:
ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;

Dhoma e shkallës së dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e dhomës së shkallës së parë se ekstrakti nga librat afarist i kreditorit në bazë të cilit është lejuar urdhri për përmbarim, nuk është dokument i besueshëm nga neni 29 paragrafi 1 të LPP-së. Kjo gjykatë vlerëson se dispozitat ligjore të lartcekura, ekstraktin financiar në këtë rast të kreditorit, e përfshijnë si dokument të besueshëm në bazë të cilit realizohet përmbarimi, pasi që edhe ekstrakti me shifrën VU.5.B.46.4177 i kreditorit, duhet trajtuar si dokument publik, që është ekstrakt, evidencë e

kreditorit për klientët, që në këtë rast paraqet gjendjen e faturës së arkëtimit, shumën e borxhit, për secilin muaj, borxhi i akumuluar për periudhën kohore 2023, dhe vlera e borxhit e bartur.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Urdhri përmbartimor P.nr.1523/23 datës 25.10.2023 i lejuar nga ana e Përmbartuesit privat Atip Mustafa.

Dhomat e shkallës së dytë nuk mund ta pranoj qëndrimin e dhomës së shkallës së parë, e cila në arsyetim të aktvendimit konteston përmbajtjen e ekstraktit të verifikuar nga librat afarist VU.5.B.46.4177 datës 26.09.2023 të kreditorit, për shkak se ky dokument nuk hyn në kuadër të dokumenteve të besueshme, se nuk mund të konstatohet se për cilën periudhë kohore është krijuar borxhi. Kjo gjykatë vlerëson se borxhi i mbledhur në total prej 294,00€ sipas ekstraktit të verifikuar në librat afarist të kreditorit, dhe propozimit për përmbartim, është borxh i akumuluar në periudhën kohore 01.01.2023-31.12.2023, për shkak të mos pagesave nga debitori. Në prapësimin e debitorit datës 06.11.2023 nuk kundërshtohet kjo shumë e borxhit e akumuluar ndër vite, dhe debitori nuk paraqet dëshmi se ka përmbush detyrimin apo një pjesë të tij, për shërbimin, në emër të bartjes së mbeturinave sipas ekstraktit me shifër VU.5.B.46.4177.

Kjo gjykatë nuk i pranoi si të bazuara pretendimet e debitorit në prapësim se ekstrakti i verifikuar i kreditorit është dokument fiktiv, se nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Siç u theksua më lartë ekstrakti i verifikuar nga librat afarist i kreditorit, është dokument i përshtatshëm për përmbartim nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3, 1.4 të LPP-së, i cili përmban edhe vulën e kreditorit, prandaj një dokument i tillë nuk mund të konsiderohet si dokument fiktiv.

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbartimit në këtë rast.

Kompetenca e Dhomës së shkallës së dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1918/24 datë 20.12.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha